



Komuna e Podujevës

Raporti i Shqyrtimit Publik dhe procesit të pjesëmarrjes në hartimin e Hartës Zonale të Komunës së Podujevës 2020-2028

Podujevë, Prill 2020

Përmbajtja

1. HYRJE	3
2. VENDIMET ME RËNDËSI TË KK-SË DHE NJOHTIME TË NDËRMARRA GJATË PROCESIT TË HARTIMIT TË HZK-SË SË PODUJEVËS	3
3. PROCESI I HARTIMIT TË HARTËS ZONALE TË KOMUNËS 2020-2028	5
4. PËRMBLEDHJA E REKOMANDIMEVE DHE VËREJTJEVE NGA AKTIVITETI I SHQYRTIMIT PUBLIK	8

1. Hyrje

HZK e Podujevës është përgaditur nga Komuna e Podujevës, bartëse e të cilit është Drejtoria për Planifikim, Urbanizëm, Gjeodezi, Kadastër dhe Mjedis. Në këtë proces komuna është mbështetur nga ekipi i konsulentëve të GIZ, programi “Fuqizimi i planifikimit hapësinor dhe menaxhimi i tokës 2017-2019”

Përgatitja e HZK së Podujevës ka kaluar nëpër një proces të përfshirjes, pjesëmarrjes dhe konsultimit të akterëve të ndryshëm dhe palëve me interes të komunës dhe më gjerë gjatë gjithë kohës së përgatitjes së dokumentit. Mënyrat e përfshirjes kanë qenë të ndryshme përshfiri format e punëtorive me pjesëmarrje më të gjerë si dhe atyre më të fokusuara, konsultime, prezantime publike, intervista, takime, aktivitete dhe manifestime të ndryshme e deri te shqyrtimi publik si forma e fundit e pjesëmarrjes së publikut i cili ka qenë i hapur për 30 ditë dhe atë prej 4 shkurtit deri më 4 mars 2020 kur dhe është mbyllur.

Në kuadër të këtij raporti janë paraqitur fazat nga marja e vendimit për përpilimin e PZHK, shkurtimisht janë dhënë edhe sqarime rreth procesit të pjesëmarrjes dhe përfshirjes gjatë hartimit të dokumentit e deri te shpallja e shqyrtimit publik si dhe komentet e dala na kjo periudhë 30 ditore.

2. Vendimet me rëndësi të KK-së dhe njoftime të ndërmarra gjatë procesit të hartimit të HZK-së së Podujevës

Vendime momentet kyçe të vendim marrjes dhe pjesëmarrjes janë:

- a. Vendimi i Kuvendit Komunal për hartimin e HZK-së: 19 Shtator 2017
- b. Vendimi i Kuvendit komunal për organizimin e shqyrtimit publik të HZK-së: 31 Janar 2020.
- c. Prezantimi publik i përmbajtjes së HZK-së gjatë periudhës së shqyrtimit publik: 21 Shkurt 2021
- d. Njoftimi për prezantimin publik të projekt-HZK-së shpallur në webfaqen e komunës: 31 Janar 2021

Vendimet:

--



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11 dhe 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 11 të Ligjit nr.04/L-174 për planifikimin hapësinor, nenin 7 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ nr.05/2014 (MMPH) për përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikimin hapësinor, nenin 13 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna, Udhëzimin Administrativ (MAPL) nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, neneve 14 dhe 15 paragrafi 2.4 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, në pajtim me nenin 35 shkronja o), dhe 37 pika 4 të Rregullores së Komunës së Podujevës për mënyrat, procedurat dhe kushtet e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset e vendimmarrjes nr.01/18-02 të datës 31 janar 2011, në zbatim të Planit të Veprimit për Transparencë për periudhën 2019 – 2023 në Komunën e Podujevës, Vendimit të Kuvendit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-948/03-0072034/17 dt.19.09.2017 për fillimin e hartimit të Hartës Zonale, si dhe aktit të vlerësimit të përputhshmërisë me nr.prot.SP-02/7116-2/19 të datës 17.01.2020 të MMPH, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 31 janar 2020, mori,

VENDIM PËR VËNIEN NË SHQYRTIM PUBLIK

Neni 1

Vëhet në shqyrtim publik

- **Projekt Harta Zonale e Komunës së Podujevës 2020 - 2028, në Komunën e Podujevës.**

Neni 2

Shqyrtimi publik sipas nenit 1, zgjat 30 ditë përkatësisht prej **04 shkurt 2020 deri më 04 mars 2020**. Debat publik me qytetarë dhe profesionist të kësaj fushe mbahet më **21 shkurt 2020** duke filluar nga ora **13:15, në ish sallën e mbledhjeve të Kuvendit në objektin e vjetër të Komunës.**

Neni 3

Propozimet, sugjerimet, apo vërejtjet eventuale paraqiten ditën e mbajtjes të debatit publik, gjithashtu në formë të shkruar mund të paraqiten gjatë kohëzgjatjes së shqyrtimit publik në Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, ndërtesa e re e Komunës zyra nr.54, si dhe në formë elektronike mund të dërgohen në e-mail adresat; nazmi.elezi@rks-gov.net dhe bujar.gimolli@rks-gov.net, të cilat pastaj përcjellën në Drejtorinë përkatëse, brenda periudhës së shqyrtimit publik.

Neni 4

Dokumenti sipas nenit 1, është pjesë përbërëse e këtij vendimi dhe i njëjti publikohet në ueb-faqen zyrtare të Komunës: <http://kk.rks-gov.net/podujeve> **(rubrika; aktet për diskutim publik)**

Neni 5

Shqyrtimi publik zbatohet nga Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Ekipi komunal për ofrimin e ndihmës profesionale për hartimin e Hartës Zonale të Komunës së Podujevës në bashkëpunim dhe koordinim me Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, që përkujdesen për përgatitjen e raportit nga diskutimi / debati publik dhe të japin sqarime për arsyeshmërinë e pranimit ose mospranimit të propozimeve dhe sugjerimeve konkrete.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi pas publikimit ueb faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 01-350/05-0007438/20
Podujevë, 31 janar 2020



Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi

3. Procesi i hartimit të Hartës Zonale të Komunës 2020-2028

Gjatë procesit të hartimit të HZK-së, aktivitete të pjesëmarrjes dhe përfshirjes së palëve të interesit dhe publik janë:

- a. Takim publik për informimin e banorëve të Kërpimehit dhe fshatrave përreth për fillimin e procesit të hartimit të HZK-së dhe kontributit të tyre: 12 Shtator 2018
- b. Takim publik për informimin e banorëve të Lluzhanit dhe fshatrave përreth për fillimin e procesit të hartimit të HZK-së dhe kontributit të tyre: 13 Shtator 2018
- c. Takim publik për informimin e banorëve të Orllanit dhe fshatrave përreth për fillimin e procesit të hartimit të HZK-së dhe kontributit të tyre: 14 Shtator 2018
- d. Takim publik për informimin e banorëve të Sfeqlës dhe fshatrave përreth për fillimin e procesit të hartimit të HZK-së dhe kontributit të tyre: 17 Shtator 2018
- e. Takim publik për informimin e qytetarëve të Podujevës përreth për fillimin e procesit të hartimit të HZK-së dhe kontributit të tyre: 18 Shtator 2018
- f. Takime pune të grupit punues të komunës për hartimin e HZK-së;
- g. Takime pune me zyrtarë të qeverisë dhe profesionistë për shtjellimin e zonave të: bujqësisë, pylltarisë, minierave e fushave të eksploatimit, zonat ujore, banimit, hekurudhave, zonat turistike etj;
- h. Punëtori për trajtimin e kushteve zhvillimore/ndërtimore në HZK: 28-29 maj 2019, Prevallë;
- i. Prezantimi publik i kushteve zhvillimore të draft-HZK: 25 qershor 2019;
- j. Dorëzimi i draft-HZK-së në MIA korrik 2019. Kërkesa nga MIA të silltet edhe raporti i VSM;
- k. Dorëzimi i draft HZK-së në MIA së bashku me raportin e VSM-së më 5 dhjetor 2020;
- l. Prezantimi i draft-HZK para MIA para se të vihet në shqyrtim publik: 12 dhjetor 2019;
- m. Periudha e shqyrtimit publik: prej 4 shkurt deri më 4 mars 2020;
- n. Prezantim publik gjatë periudhës së shqyrtimit publik: 21 shkurt 2020
- o. Shqyrtimi i komenteve nga grupi punues dhe përpilimi i raportit të shqyrtimit publik;

Foto nga këto takime:

Takim në Kërpimeh




Raport nga Shqyrtimi Publik për Hartën Zonale të Komunës

Takim në Orllan



Takim në Sveqel



Takim në Podujevë



Raport nga Shqyrtimi Publik për Hartën Zonale të Komunës

Prezantimi gjatë shqyrtimit publik - Pudujeve



4. Përmbledhja e rekomandimeve dhe vërejtjeve nga aktiviteti i Shqyrtimit Publik

Nr	Burimi i rekomandimit	Komenti/vërejtja/sygjerimit	Pranohet/refuzohet	Arsyetimi i pranimit apo refuzimit të komentit
1	Shaip Haxhiu, Mustafë Demiri, Sefedin Hoti Pronarë	Ndërtim të lartë në zonën, Rr. Zahir Pajaziti parcela Nr: 00324-0. dhe 00320-3. dhe 320-2 nuk kemi mundësi që të bashkojmë 25-35 ari.	Refuzohet	Kjo zone është parapare P+11 – afër komunes. Keto tri parcela bashke kane 9.7ari. Do të pranohet vetëm nëse bashkohet me parcelat e afërta për të arritur normën e kërkuar sipas kushteve të dhëna me draft HZK-në.
2	Ramadan Kameri Pronar	Ndërrim destinimi nga toka bujqësore në tokë ndërtimore e parcelës 02641-1 meqë të gjitha parcelat tjera janë ndërtimore	Refuzohet	Kërkesa nuk qëndron. Parcela në fjalë e ka destinimin “Shfrytëzim i përzier”, sikur të gjitha parcelat tjera fqinje që janë afër rrugës magjistrale” në zonën urbane.
3	Imer Hajdini Pronar	Verifikim i zonës kadastrale në rr.Merqezi për ndërtim P+2 të bëhet në P+9 ku parcela ka rreth 14 ari.	E paqartë	Cila është rruga Murqezi
4	Artan Duriqi Pronar	Ndërrim destinimi nga toka bujqësore në tokë ndërtimore e parcelave : - 01355-0- zona kadastrale-Obrançë - 01356-1- zona kadastrale-Obrançë - 01356-2- zona kadastrale-Obrançë - 01356-3- zona kadastrale-Obrançë pasi që kemi në plan të investojmë-ndërtojmë objekte retroaktive.		Të qartësohet kërkesa..objekte retroaktive? A është menduar për objekt rekreacionit? Toka është pyjore, por sic shihet në ortofoton e vitit 2018 pyjet janë prerë. Kërkesa nuk mund të pranohet pa u ditur qartë se çfarë lloj objekti është menduar të ndërtohet në mënyrë që të dihet nëse parcelat respektive kanë sipërfaqen e duhur për të respektuar kushtet ndërtimore. 2012 (tokë pyjore) 2018 (pyjet e prera)
5	Arif Arifi Pronar	Ndryshim etazhiteti në parcelat: 554-0, 555-0, 556-0 të cilat janë 3 parcela në qendër të qytetit në kryqëzimin e rrugës Rr.Zahir Pajaziti , në 19 Qershori, ne kërkojmë që në këtë hapësirë 14 ari të më lejohet ndërtimi P+7, ku sipas hartës zonale nevojitet 25 ari për lartësi P+7 , sepse nuk kam asnjë bashkëpronar ku mund ta arrijmë hapësirën prej 25 ari, ju lutem është madhore për një ndërtesë banesore dhe investimi është i gatshëm, nevojat për një objekt banesor janë të mira sepse ka qasje në dy rrugët kryesore Rr.Zahir Pajaziti dhe në 19 Qershori.	Refuzohet	Kushtet janë përcaktuar për etazhitet janë dhënë për blloqe. Gjithashtu, madhësia e parcelës duhet të jetë në përputhshmëri me kushtet e caktuara në HZK.
6	Shaip Avdullahu Pronar	Ndryshim destinimi nga toka bujqësore në atë ndërtimore, pasi që në atë parcelë gati veç është mbushur me shtëpia, fleta poseduese me numër P-71712076-00256-6 dhe me numër të parcelës 00256-6 Surkish afër shkollës tek lagjja e Kuvajtit.	Pranohet	Pasi që aty tashmë ka ndërtime. Ndryshimi të reflektohet në hartë.
7	Arif Arifi Pronar	Ndryshim destinimi i pjesës së mbetur (gjysmës) të parcelës nga toka bujqësore në industriale në parcelën 265-1 zona kadastrale në Livadicë , sepse gjysma e arës të njëjtë ka mbetur zonë bujqësore në vend që të bëhet industriale.	PRANOHET	Kjo kërkesë mund të merret parasysh nëse industria që planifikohet i përket industrive që kemi planifikuar për territorin e komunës. Vendimi i KK Podujevë për caktimin e zonës industriale në Livadicë ka pasur gabime në disa nr. të parcelave, andaj ka mundësi që kjo parcelë të jetë brenda zonës së shpallur industriale siç thotë pronari, por nr. i parcelës nuk ka figuruar në vendimin e KK.

Raport nga Shqyrtimi Publik për Hartën Zonale të Komunës

8	Labinot Murati Pronar	Ndryshim destinimi i pjesës së mbetur (gjysmës) të parcelës me nr.626 dhe 627 nga toka bujqësore dhe gjysma tjetër banim P+2. Kërkoj të bëhet P+5 e gjithë parcela pasi që është një zonë shumë afër qytetit. Që të pëfshihet në sipërfaqen e destinuar për tokë industriale pasi që ne i kemi blerë dhe janë pjesë e fabrikës “Euro bllok”	Refuzohet	Refuzohet është jashtë zonës së dënuar urbane!
9	Ismet J. Shabani, Verdi H. Shabani; Avni I. Shabani Shaban J. Shabani Pronarë	Llapashticë e Poshtme Të lejohet ndërtimi në parcelat: 789-0 dhe 789-2; 788-6; 788-5 dhe 784-2; 788-2, 788-1, 784-7 Parcelat të gjitha në ballë të rrugës magjistrale Prishtinë-Podujevë	Pranohet	Me qëllim të trajtimit të barabartë, të gjitha parcelat e mbetura në anën e djathtë të rrugës nacionale (shih ortofoton më poshtë) shndërrohen në tokë ndërtimore ku edhe në afërsi është planifikuar banim me funksione tjera. Nëse i referohemi zhvillimit që nga 2012 (shih ortofoton e vitit 2012) dhe situatës aktual (shih ortofoton 2018), shihet se pronarët gjatë kësaj periudhe vecse kanë bërë ndërtime në këto parcela. Trajtimi i tyre do t'i nënshtrohet dispozitave të ligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje. Ndryshimi të reflektohet në hartën respektive
10	Faton Aliu Pronar i kompanisë NTSH te Muslia	Parcela me nr.00572-0-1 që të mundësoj që nga toka bujqësore të kthehet në tokë ndërtimore që ne të zhvillojmë biznesin tonë në hapësirë më të gjerë.	Kjo parcelë gjendet në fshatin Sekiraqë , në rr. Magjistrale PD – PR. ,afër pompës “Alb Petrol” Pranohet pjesërisht.	Për te gjitha parcelat në afërsi të kësaj parcele, pjesërisht janë dhënë shfrytëzim i përzier dhe pjesërisht tokë bujqësore. Andaj kjo kërkesë refuzohet si e tërë. Biznesi mund të zhvillohet edhe ne hapësirën për të cilën është zonuar si shfrytëzim i përzier.
11	Islam Lushaku Pronar	Parcela me nr.044770000 që të mundësoj që nga toka bujqësore të kthehet në tokë ndërtimi që ne të zhvillojmë ndonjë biznes apo ndërtim të lartë.		Nuk është i qarte nr i parceles. Te paktën ta kishte shëno ne cilën zone kadastrale është?
12	Lutfi Beselica Pronar	Ndërrim destinimi i parcelave për minierë sepse kemi planifikuar që të bëjmë zgjerimin e minierës ekzistuese, kemi bërë projektin dhe jemi në procedura për marrjen e lejes nga MMPH si dhe KPMM. Parcelat për të cilat kemi planifikuar janë: Llapashticë të Poshtme 464-0, 463-0, 460-2, 61-0, 462-0 , 457-0, 456-0, 458-2, 455-0, 452-0, 451-0; Obrançe parcelat 1497-4, 1865-2	Pranohet	Nëse merret pëlqimi nga MMPH dhe KPMM. Ndryshimi të reflektohet në hartë por si hapësirë e mundshme për zgjerim. Dy parcelat ne Obrance nuk po mundemi ti gjejmë.
13	Halim Beselica Pronar	Planifikimi në Qendra 3 Jug nga rr.Skenderbeu për shkollën fillore, cerdhe-kopsht, ambulancë, teren sportiv sepse mungojnë në pjesën tonë dhe fëmijët udhëtojnë larg.	REFUZOHET	Komuna e Podujevës nuk ka të planifikuar shërbime sociale shtesë në këtë pjesë të qytetit, pasi që ato mbulohen me objektet që janë në pjesët më të afërme të kësaj tërësie.
14	Fuad Haziri Pronar	Kërkojë që parcela 02487-0 dhe 2484-0 që nga toka bujqësore të bëhet e planifikuar për ndërtim.	PRANOHET	Për arsye se kjo zonë është në mes të zonës së ndërtuar kjo kërkesë pranohet.
15	Ardita Abdullahu Pronare	Parcela në Rr. Ali Ajeti është P+2 të bëhet në P+7 konkretisht në numrin e fletës poseduese P-71712062 dhe në numër parcelës 03029-3, pasi që në këtë parcelë kam 20 ari.	Refuzohet	Kjo zonë e tëra është planifikuar me P+2. Dendësia në këtë zonë nuk është planifikuar të jetë më e madhe.
16	Shefki Muqolli	3 parcela me nr.P-71712062,01470-1, P-71712062-0147-2, P-71712062-01470-3	PRANOHET	Për arsye se kjo zonë është në mes të zonës së ndërtuar kjo kërkesë pranohet.

Raport nga Shqyrtimi Publik për Hartën Zonale të Komunës

		Rr.Vllezërit Frashëri parcela si tokë bujqësore të parashihet si ndërtimore meqë të gjitha trojet për rreth janë të parapara për ndërtim të lart banesorë dhe koeficienti të jetë P+7 si tokë për ndërtim. Kërkoj trajtim të barabartë në këtë aspekt pronësor.		
17	Tahir Rexhepi Pronar	Parcela te Rr.Bajram Krasniqi ,ish rruga 28 Nëntori-përballë shkollës Shaban Shala, është klasifikuar si tokë në shërbim industrial-komerciale P+7. Kërkesa është e protokoluar në shenjëzimin në hartë, klasifikimi i tokës nr.parcelës dhe etazhiteti.	Parcelat janë: 275-0 , 276-0 , 278-1 , 278-2 etj. Janë në drejtimin (Jug – përballë shkollës) . Kërkohet nga P+7 Në P+10 PRANOHET	Kjo kërkesë merret parasysh për shkak se, i gjithë blloku është P+9.
18	Hazir Haziri Pronar	Parcela 2485-4 dhe 2485-5 të ju ndërrohet destinimi nga toka bujqësore në ndërtimore.	PRANOHET	Për arsye se kjo zonë është në mes të zonës së ndërtuar kjo kërkesë pranohet.
19	Mustaf Emini Banor i fshatit XXX	Banor i fshatit, i bashkangjitem kësaj kërkesë për parcelën në fjalë për ndërtimin e një ose për pritjet e një xhamie.	???	Kërkesa është e pakompletuar.
20	Adiat Hajdari Pronar	Parcelave të familjes Hajdari te rr.Zahir Pajziti përballë shkollës ekonomike, të ju rritet shfrytëzimit i ndërtimit, për arsye se jemi familje e madhe dhe na nevojitet për shfrytëzim banimi. Të gjitha parcelat i kemi mbi 10 ari.	Refuzohet	Nuk janë dhënë numrat e parcelave. Mirëpo parimisht nuk mund të rritet shfrytëzueshmëria e parcelës për parcelat të veçanta.
21	Mustaf Demiri Shaip Haxhiu Pronarë	Kërkojmë ndërtim të lartë në zonë rr."Zahir Pajziti" me numër të parcelës 00324-0 dhe 00320-3 dhe 3220-2 nuk kemi mundësi që të bashkojmë 25-35 ari.	Refuzohet	Në këtë zonë është i planifikuar i ndërtimi i lartë (P+11 – afër komunës) i cili për tu arritur kërkon madhësinë e parcelës. Pronarët për të arritur këtë zhvillim duhet të bashkojnë parcelat e tyre me parcelat e afërta.
22	Agim Behluli Pronar	Parcela në pjesën pas kishe rr."Ali Ajeti" është paraparë park në pronat private. Ju lusim që të shikoni në ri planifikim që kjo pjesë të lejohet për ndërtim pasi që pjesa dërmuese është e ndërtuar.	E paqartë lokacioni	Të saktësohet parcela. Parimisht nuk është caktuar park në asnjë tokë private.
23	Selatin Bllaca Pronar	Të rishikohet destinimi në rrugën që lidh Ballofcin dhe Shajkofcin nga xhamia tek lagjia e Kuvajtit përballë Llallosheve nga tokë bujqësore në atë ndërtimore pasi që është gati në përfundim të ndërtimit	E paqartë lokacioni	Duhet të kërkohen informata më të sakta për lokacionin, mundësisht nr. i parcelës.
24	Rrustem Jetullahu përfaqësues i fshatit Shakovic	Kërkojmë të na lejohet ndërrimi i destinimit të parcelës me nr.00220-2 nga toka bujqësore në tokë ndërtimore në mënyrë që të kemi mundësi të ndërtojmë një odë pritje dhe një xhami për fshatin Shakovic.	Pranohet	Pasi që është për të mirën e komunitetit, megjithëse toka i përket klasës së II-të. Sipas të dhënave në dispozicion fshati Shakovicë nuk ka xhami tjetër. Nëse jo atëherë pranohet dhe të bëhet ndryshimi në hartë. Ndryshimi të reflektohet në draft-HZK (kushtet dhe plani i veprimit)

Raport nga Shqyrtimi Publik për Hartën Zonale të Komunës

25	Muhamet Maloku Pronar	Të shqyrtohet parcela tek Hotel Besiana destinimi dhe etazhiteti të mos të jetë vetëm shërbim tregtar po të ketë edhe banim pasi që në këtë parcelë ka punuar Hotel Besiana. Mundësisht etazhiteti të jetë P+11 pasi që edhe hoteli ka pasur etazhitet P+7	PRANOHET	Pranohet të jetë P+11.
26	Agim Behluli Pronar	Të rivlerësohet harta zonale në rr.Ali Ajeti në të cilën është vlerësuar ndërtim P+2 të shtohet së paku në P+5 siç është nën hekurudhë. Vendi është në tokë fortë d.m.th.guror dhe mendojmë se është e rrugës të riplanifikohet.	Refuzohet	Edhe pse pronari nuk ka dhënë numrin e parcelës. Parcelat mbi hekurudhë nuk janë planifikuar të jenë më shumë se P+2 .
27	Behar Zullufi Pronar	Kërkoj planifikimin për ndërtimin deri në P+12 që është dëshirë e gjithë lagjes Rr.Skenderbeu tek ETC	Refuzohet	Supozohet se parcela mund të jetë në pjesën e rrethuar me të kaltër (rruga Skenderbeu deri te ETC) meqenëse pronari nuk ka dhënë numrin e parceleva të lagjes që i referohet. HZK nuk ka paraparë etazhitet më të madh se P+5.
28	Blerim Beqiri Pronar	Të rishikohet harta zonale pasi që në rr.Ali Ajeti nga hekurudha e deri te rruga për Merdar të përmirësohet nga P+2 në P+7 sepse si lagje dhe pozitë i takon të jetë në P+7.	Refuzohet	Edhe pse pronari nuk ka dhënë numrin e parcelës. Por pavarësisht kësaj, kjo zonë nuk mund të planifikohet me dendësi më të madhe se sa është përcaktuar me këtë HZK .
29	Lutfi Beselica Pronar	Të përfshihem në tokë ndërtimore parcela me numër 2188-0, 2186-0, 15-23-2, 1524-0 në Podujevë sepse këto parcela kanë qenë me planin detaj të Podujevës tokë ndërtimore dhe janë afër në kufij me vendbanime.	Pranohet	Për arsye se kjo zonë është në mes të zonës së ndërtuar kjo kërkesë pranohet.
30	Petrit Islami Pronar	Pse në hartën zonale nuk janë të pranishme të dhënat e parcelës në zonën jashtë qytetit psh Gllamnik.	E paqartë	Nuk është e qartë kërkesa. Të kontaktohet pronari dhe merret sqarim.
31	Meriton Rrahimi Pronar	zona Podujevë rr.Xhemajl Mustafa në afërsi të fabrikës së armaturave është P+2 të ndryshohet në P+7.	Refuzohet	Emrin e rrugës nuk e gjejmë dhe meqenëse pronari nuk ka dhënë numrin e parcelës është vështirë të lokalizohet parcela. Por pavarësisht kësaj, kjo zonë nuk mund të planifikohet me dendësi më të madhe se sa është përcaktuar me këtë HZK .
32	Bahri Mehmeti Pronar	rr.Ali Ajeti Podujevë nga hekurudha e deri tek vendi i quajtur te banderi është gabim planifikimi për ndërtimin me P+2.Në atë lagje duhet të jetë së paku P+5 deri në P+7.	Refuzohet	E njëjta kërkesë si 26 dhe 28. Meqenëse pronari nuk ka dhënë numrin e parcelës. Por pavarësisht kësaj, kjo zonë nuk mund të planifikohet me dendësi më të madhe se sa është përcaktuar me këtë HZK .
33	Gëzim Abdullahu Pronar	Zona 3 Podujevë rr.Ali Ajeti e kemi llogaritur për P+2 ju lutem bëjeni këtë kërkesë që të mundësohet ndërtimi për P+7.	Refuzohet	
34	Mustafë Beqiri Pronar	rr.Ali Ajeti keni thënë për ndërtim që është P+2 përtej Maqanëve andaj kërkoj nga P+2 në P+7.	Refuzohet	
35	Esat Ejupi Pronar	të rishqyrtoj hartën zonale në Sekiraqë-Gllamnik në pjesën ku është paraparë për ndërtim sepse gjendja e popullsisë shkakton zënien e tokës pjellore andaj duhet të shqyrtohet mundësi për ndërtim me më shumë kate.	Refuzohet deri ne P+2 max	Në HZK fshati Gllamnik hyn tek Sipërfaqet rurale me intensitet të lartë, me dendësi të planifikuar deri Prej 26- 50 b/ha, etazhitet P+2.
36	Shemsi Zhjeqi Pronar	Zona sipër hekurudhës pranë parkut te kisha afër rrugës Bedri Sokoli, është parashikuar që etazhiteti P+3 kërkesa ime është që etazhiteti të jetë P+10.	Refuzohet	Kjo zonë nuk është paraparë të jetë me dendësi më të madhe.
37	Behxhet Rrmoku	parcela 01939-0,01940-0, Zona Podujevë Rr.Xhafer Rrahman Mehmeti, të lejohet ndërtimi i fabrikës. Kjo zonë është parashikuar zonë bujqësore kërkesa është të bëhet tokë ndërtimore.	Refuzohet	Parcelat jane jashtë kufijve të caktuar ndërtimor.

Raport nga Shqyrtimi Publik për Hartën Zonale të Komunës

38	Vahedin Avdullahu Pronar	Zona Podujevë Rr."Ali Ajeti", 100m përtej hotel Ilirisë –djathtas nga P+2 të ndryshojë në P+5	Refuzohet	Kjo zonë për 8 vitet e ardhshme nuk mund të planifikohet me dendësi më të madhe se sa është përcaktuar me këtë HZK.
39	Gëzim Namani Pronar	Ta shqyrtojë lejin e ndërtimit nga P+2 në P+7 në Rr. Ali Ajeti me numër të parcelës 01740-0 dhe 01741-0, gjegjësisht përballë trafos ana e majtë si të kalohet hekurudha, si dhe kjo të kalohet nga destinimi –banimi i përhershëm (BP) në atë me banim me funksione tjera më të përshtatshme (BFT).	Refuzohet dhe pranohet	Refuzohet për etazhitet ndërsa për shfrytëzim banim me funksione tjera në pajtueshmëri pranohet. Ndryshimi të reflektohet në hartë si etazhitet P+2.
40	Burim Berisha Pronar	Ta shqyrtoj lejin e ndërtimit nga P+2 në P+7 në Rr. Jusuf Koliqi me numër të parcelës 01751-0, ana e majtë si të kalohet hekurudha, si dhe kjo të kalohet nga destinimi –banimi i përhershëm (BP) në atë me banim me funksione tjera në përshtatshmëri (BFT)	Refuzohet	Parcela qështë në BFT, rritja e etazhitetit nuk merret prasysh.
41	Milazim Namani Pronar	Të shqyrtohet lejimi i ndërtimit nga P+2 në P+7 në Rr. Jusuf Koliqi me numër të parcelës 01775-4 dhe 01775-3 , ana e majtë si të kalohet hekurudha, si dhe të na bëhet e mundur edhe neve që kjo pjesë të kalohet nga destinimi – banimi i përhershëm (BP) në atë me banim me funksione tjera më të përshtatshme (BFT).	Refuzohet	Parcela është në BFT, rritja e etazhitetit nuk merret prasysh.